

MENDIMI SOCIOLOGJIK SHQIPTAR

Bibliografi
1986-2006

Përgatitur nga Fatos Tarifa & Lekë Sokoli

Me një koment nga Jay Weinstein



Instituti i Sociologjisë

Mendimi sociologjik shqiptar

(1986 -2006)

Bibliografi

Përgatitur nga

Fatos Tarifa & Lekë Sokoli

Me një koment nga

Jay Weinstein

IS & Rinia

Përgatiti për botim:
Instituti i Sociologjisë

Arti Grafik:
Orest Muça

ISBN 99927-819-8-X
© Autorët, 2006

Botues:
IS & Rinia

Instituti i Sociologjisë
Rr. "Abdyl Frashëri", p. 3/3, Tiranë
Tel & Fax.: ++355 4 268 819
E-mail: lsokoli@instituti-sociologjise.org
www: instituti-sociologjise.org

LËNDA

| | |
|--|----|
| Koment nga Jay Weinstein | 5 |
| Parathënie | 11 |
| Libra sociologjikë | 17 |
| Studime, artikuj studimorë dhe kapituj librash | 43 |
| Artikuj publicistikë mbi sociologjinë dhe mbi dukuri sociologjike | 93 |

Koment

Prof. Jay Weinstein
Eastern Michigan University

Bibliografitë kanë qenë dhe mbeten instrumente të nevojshëm në çdo fushë studimesh akademike. Ato përbëjnë një burim të dobishëm informacioni për këdo që nuk është i familjarizuar sa duhet me një fushë të caktuar studimi dhe literaturën e shkruar për të. Kjo bibliografi librash, artikujsh, esesh dhe kapitujsh hartuar dhe redaktuar nga Fatos Tarifa dhe Lekë Sokoli do t'u jetë veçanërisht e dobishme studiuesve shqiptarë dhe të huaj, të cilët janë të interesuar të studiojnë jetën politiko-sociale në Shqipërinë postkomuniste dhe dukuri të veçanta të saj.

Projekti tashmë i realizuar i një bibliografie të tillë është unikal, pa precedent, dhe shumë i rëndësishëm në disa aspekte. Në vështrim të parë, një bibliografi që identifikon punimet e autorëve shqiptarë, të cilët kanë shkruar dhe botuar në kuadër të disiplinës së sociologjisë apo shkencave shoqërore të afërta me të, mund të duket si diçka që nuk paraqet ndonjë interes të vacantë. Por asgjë nuk mund të jetë më i gabuar se ky opinion për ata që janë të njohur me historinë e lindjes dhe të zhvillimit të sociologjisë në Shqipëri si edhe me biografitë e intelektualëve dhe aktivistëve shoqërorë, veprat dhe punimet e të cilëve përfshihen në këtë bibliografi. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse mbajmë parasysh ndërlidhjen e rëndësishme që ekziston midis historisë dhe biografisë, të cilën C. Wright Mills ishte i pari që e veçoi si gjënë më të rëndësishme të imagjinatës sociologjike.

Lindja e sociologjisë në Shqipëri koïncidoi me fillimin e tranzicionit të vendit nga një sistem i mbyllur autoritarist, në të cilin aparati kulturor ishte i asfiksuar nga një ortodoksi ideologjike, në një shoqëri të re demokratike me mundësi të shumta për zhvillimin e një sfere publike autentike. Dy ngjarje kryesore e stimuluan lindjen e sociologjisë në Shqipëri, ngjarje, të cilat jo rastësisht luajtën një rol të rëndësishëm në tranzicionin social-politik të këtij vendi. Në të vërtetë, këto episode kanë qenë pikërisht të atij tipi ngjarjesh përcaktuese të eksperiencave të përbashkëta njerëzore, të cilat Karl Mannheim i quante burimin e dallimeve midis brezave: kur një gjeneratë ka qenë socializuar përpara këtyre ngjarjeve dhe tjetra në periudhën pas tyre. Ngjarja e parë ka qenë krijimi i Shoqatës Sociologjike Shqiptare në nëntor 1990, një ngjarje pak e njohur, por të cilën unë e kam konsideruar si një moment vërtet të rëndësishëm në historinë e sociologjisë së aplikuar. E dyta, në verë të vitit 1991, ishte mësimi i sociologjisë si një disiplinë e ligjshme akademike për të parën herë në sistemin e arësimit të lartë në Shqipëri. E konsideruar më parë si një “shkencë borgjeze” nga regjimi komunist, sociologjia u lejua në atë kohë të bëhej pjesë e mjedisit akademik dhe kulturor shqiptar.

Përsa i përket ngjarjes së parë, redaktorët e këtij vëllimi, në një artikull botuar kohët e fundit në SHBA kanë shkruar se krijimi i Shoqatës Sociologjike Shqiptare ishte

një konfirmim i së vërtetës se toleranca dhe mendimi i lirë ishin të domosdoshëm për krijimin e një sfere publike, e cila do të shërbente për të amortizuar konfliktin midis shtetit dhe shoqërisë dhe do të ndihmonte krijimin e shoqërisë civile. Emërtimi i asaj shoqate “Shoqatë Sociologjike” kur në Shqipëri nuk kishte ende sociologë të shkolluar si të tillë, sidoqoftë, nuk ishte shjesht rastësor. Ajo mund të ishte emërtuar fare mirë “Shoqata e Intelktualëve Shqiptarë” nga që në radhët e saj bënin pjesë disa nga

intelektualët më të njohur dhe më të respektuar të vendit në atë kohë, të cilët vinin nga fusha të ndryshme të dijes dhe të kulturës. Edhe pse nuk ishte një shoqatë profesionale sociologësh, anëtarët e saj kishin një besim intuitiv në aplikueshmërinë dhe dobinë shoqërore praktike të dijes sociologjike si edhe në aftësinë e saj transformuese në një shoqëri të hapur dhe liberale.

Në vitin 1990, në Shqipëri sociologjia u bë, si të thuash, sinonim i ndryshimeve sociale dhe kulturore. Ajo nënkuptonte gjithashtu ndryshime politike edhe pse kjo nuk pohohej hapur. Në të vërtetë, duke përfaqësuar një grup individësh të asociuar me njëri-tjetrin vullnetarisht për të formuar një “publik”, i cili kishte dëshirën dhe vullnetin të influenconte politikat shtetërore dhe shoqërinë civile në emër të “interetit të përbashkët”, Shoqata Sociologjike Shqiptare i kontribuoi në atë kohë krijimit të një rrjeti të lirë komunikimi në sferën publike, i cili pa kaluar shumë kohë do të “konkuronte” me pushtetin publik, pushtetin që, siç shprehet sociologu i shquar francez Pierre Bourdieu, dominon “hapësirën sociale” dhe “autorizon gjuhën e zyrtarizimit dhe të legjitimitimit të të gjitha marrëdhënieve sociale” (Tarifa & Sokoli, 2006: 86).

Ky interpretim i përgjithshëm i “sociologjisë” vazhdon të mbetet karakteristikë për këtë disiplinë edhe në kushtet e sotme në Shqipëri, siç pasqyrohet kjo në shumë nga rubrikat e kësaj bibliografie, veçanërisht në pjesën e tretë të saj. Ajo që bie në sy është se një vëllim i konsiderueshëm krijimtarije që mund të quhej “sociologji publike” është botuar dhe vazhdon të botohet në organet e shtypit të përditshëm shqiptar. Një pjesë e mirë e saj është shkruar nga autorë, të cilët nuk janë sociologë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, të arsimuar dhe formuar si të tillë, por që kanë zhvilluar një farë imagjinate sociologjike, të cilën në mënyrë aktive e diskutojnë me publikun e gjerë.

Përsa i përket ngjarjes së dytë — përfshirjes së sociologjisë

si disiplinë në *academe* — kjo disiplinë fillimisht ngjalli një interesim shumë të madh midis të rinjve dhe ishte

e treta ndër degët më të preferuara të Universitetit të Tiranës, pas mjeksisë dhe drejtësisë. Interesimi dhe pasioni i studentëve shqiptarë për sociologjinë më 1991 mund të krahasohen vetëm me kuriozitetin dhe interesimin e studentëve amerikanë sot për teknologjitë më të fundit të informacionit apo për inxhinierinë gjenetike. Krijimi i Shoqatës Sociologjike Shqiptare më 1990, roli dhe ndikimi i saj në qarqet intelektuale të vendit si edhe përpjekjet e pavarura të një numri studjuesisht të shkencave shoqërore inkurajuan krijimin në verë të vitit 1991 nga Qeverisa e Stabilitetit të një fakulteti të ri në Universitetin e Tiranës, Fakultetit të Filozofisë dhe Sociologjisë (Tarifa & Sokoli, 2006: 84).

Redaktorët e këtij vëllimi dhe disa nga autorët, punimet e të cilëve përfshihen në këtë bibliografi, kanë qenë personalisht pjesmarës në njërën apo në të dyja këto ngjarje të rëndësishme. Një fakt i tillë e bën këtë bibliografi edhe më koherente, pavarësisht problematikave shumë të larmishme që përfshihen në të, të cilat variojnë nga çështje të politikës, politikat sociale, martesat dhe familja, problemet morale, demokracia dhe shteti ligjor, probleme të tranzicionit postkomunist, reformat ekonomike, zhvillimet demografike, rinia dhe transformimet kulturore.

Një tjetër burim koherence në këtë projekt është fakti që krijimi i Shoqatës Sociologjike Shqiptare dhe institucionalizimi i sociologjisë akademike në Shqipëri kanë qenë ngjarje gjeneratë-formuese. Në bibliografi kjo duket qartë në bashkëpunimin midis disa prej eksponentëve të profesoriatit të vjetër, si Hamit Beqja, Servet Pëllumbi apo Alfred Uçi, me studiuesit më të talentuar shqiptarë (në atë kohë 20 e ca apo 30-vjeçarë ndërsa sot 40 e ca apo 50-vjeçarë (si redaktorët e këtij vëllimi Fatos Tarifa and Lekë Sokoli, Artan Fuga, Albert Doja apo Ilir Gëdeshi) dhe

studiues të talentuar më të rinj në moshë, si Arjan Gjonça apo Klarita Gërxhani. Përfshirja e botimeve të tyre shkencore në këtë bibliografi përbën një kombinim interesant, koherent dhe me vlerë njohëse.

Diçka tjetër interesante që spikat në këtë bibliografi është një masë e spikatur kozmopolitanizmi, i cili kurrë s'do të kish qenë i mundur në kushtet e regjimit komunist. Lexuesi do të vejë re se një vëllim i konsiderueshëm studimesh dhe botimesh shkencore janë realizuar si bashkëpunim i studjuesve shqiptarë të shkolluar në Shqipëri apo atyre që kanë fituar doktoratura në universitete amerikane dhe evropiane (disa prej të cilëve nga më të njohurit në botë) dhe një numri studjuesish të huaj nga institucione akademike në Amerikën veriore apo në Evropën Perëndimore. Po të mbahet parasysh periudha relativisht e shkurtër në të cilën është bërë i mundur kërkimi i lirë në fushën e sociologjisë dhe shkencave të tjera shoqërore në Shqipëri, konstatimi i mësipërm flet për një nivel të habitshëm kozmopolitanizmi në fushën e studimeve sociale në Shqipëri, çka është një element dhe kërkesë e studimeve sociale bashkëkohore.

Nga një pikëpamje tjetër, punimet e përfshira në këtë bibliografi përçojnë edhe një mesazh disi më të errët. Aq sa janë produkt i një periudhe tepër interesante, optimiste dhe kreative të tranzicionit, ato fatkeqësisht pasqyrojnë edhe gjëndjen aktuale stresuese të zhvillimeve në Shqipëri si një *status quo ante*. Edhe pse ngjarjet e viteve 1990-1991 ishin

premtuese për krijimin e një shoqërie civile të shëndetshme dhe vibrante, shpejt u bë e qartë se marrëdhëniet shtet/shoqëri nuk kishin ndryshuar shumë nga koha e vjetër. Autoriteti politik vazhdonte t'i bënte rezistencë debatit publik racional-kritik dhe të mbështetej në metoda të ngjashme me ato të periudhës së socializmit shtetror [...] Kurdo që drejtuesit politik të shtetit i drejtoheshin "publikut", qëllimi ishte jo të kërkonin ndihmën e tij në hartimin e politikave publike por thjesht manipulimi i

“publikut” për të gjeneruar momentalisht mbështetje politike dhe legjitimitet (Tarifa & Sokoli, 2006: 87).

Eksperienca të tilla nuk janë ekskluzivisht shqiptare. Ato nuk janë gjithashtu unikale për vendet ish komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore. Ato janë pjesë e situatës njerëzore në fillim të shekullit të 21-të. Në këtë kuptim, kjo bibliografi shpreh një preokupim universal, veçanërisht për ata, të cilët kanë aftësinë të dallojnë në mikrokozmosin në të cilin jetojmë makrokozmosin, pjesë e të cilit jemi të gjithë si qenie shoqërore.

REFERENCE:

Tarifa, Fatos & Lekë Sokoli. 2006. “Applying Sociology to the Construction of a Democratic Public Sphere in Albania.” *Journal of Applied Sociology / Sociological Practice* 23(1)/8(1): 83-90.

Parathënie

Ky vëllim është vetëm një përpjekje e parë për të eksploruar, identifikuar dhe paraqitur në një mënyrë pak a shumë sistematike krijimtarinë teorike dhe publicistike të autorëve shqiptarë në fushë të sociologjisë dhe në disiplina të tjera të afërta me të. Si çdo përpjekje e parë, edhe kjo e jona është e papërsosur. Por një bibliografi e papërsosur, nëse ajo është e nevojshme dhe e dobishme, është gjithnjë më e mirë se një mungesë e ndjeshme dhe e pajustificuar e saj. Kjo është arsyeja që ne vendosëm të përgatisim këtë bibliografi, të bindur se ajo do të jetë e dobishme për cilindo studiues shqiptar apo të huaj, brenda apo jashtë vendit, që dëshiron të eksplorojë një terren, i cili sa vjen e bëhet më produktiv dhe më i begatë.

Edhe pse në kalendarin historik periudha 20-vjeçare (1986-2006), e marë në shqyrtim në këtë bibliografi nuk është një periudhë e gjatë, ajo ka qenë një periudhë tepër e ngjeshur me ngjarje dhe dukuri, të cilat paraprinë, shoqëruan dhe vazhdojnë të shoqërojnë shndërrimet e mëdha politike, ekonomike e sociale të shoqërisë shqiptare në një periudhë krejt të veçantë të historisë së saj, siç është ajo e tranzicionit nga socializmi shtetëror në një sistem të demokracisë pluraliste dhe të ekonomisë së tregut të lirë.

Pse pikërisht periudha 1986-2006? Në pamje të parë këto vite nuk shënojnë një periudhë e cila të përcaktojë në mënyrë pak a shumë rigorozë “kufijtë” kohorë të një kapitulli të veçantë në shoqërinë apo shkencën shqiptare. Dikush mund të mendojë se viti 1986 është zgjedhur për të shënuar fillimin e një periudhe “liberalizimi” dhe “hapjeje” në jetën politike dhe atë shoqërore të Shqipërisë, një vit pas vdekjes së liderit komunist Enver

Hoxha. Sidoqoftë nuk është kjo arësyeja pse është zgjedhur viti 1986. Ky vit vërtet i jep kuptim dhe motivimin kryesor hartimit të kësaj bibliografie njëzet vjet më vonë, por për një arësye tjetër. Kjo arësye, me përjashtim të pak njerëzve, kryesisht atyre që më 1986 kanë qenë studentë në vitin e tretë të degës së filozofisë në Fakultetin e Shkencave Politike e Juridike të Universitetit të Tiranës, ka qenë dhe mbetet e panjohur për shumicën e studiuesve shqiptarë në disiplinat e shkencave shoqërore, madje edhe për studentët e sotëm të sociologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale. Më 1986, për të parën herë në historinë e arsimit të lartë shqiptar, sociologjia filloi të jepej mësim si një disiplinë e veçantë, ndonëse akoma në atë kohë e palegjitimuar nga politika arsimore zyrtare.

E konsideruar deri në atë kohë nga sistemi politik ekzistues dhe propaganda e tij si një “shkencë borgjeze”, më 1986, pas një “aprovimi” gjysëm zyrtar, sociologjia u përfshi në programin mësimor të degës së filozofisë si një “kurs special” mbi “probleme dhe metoda të sociologjisë”. Për herë të parë studentët shqiptarë filluan të dëgjojnë në një auditor universitar t’u flitej për sociologjinë krahas me (dhe 3-4 vjet më vonë në vend të) materializmit historik marksist, me të cilin ajo ishte identifikuar deri në atë kohë. Dr. Servet Pëllumbi dhe Dr. Fatos Tarifa ishin të parët lektorë të sociologjisë në një universitet shqiptar. Leksionet e tyre në atë kohë shënuan, në një kuptim real të fjalës, krijimin e disiplinës sociologjike në Shqipëri dhe hapin e parë drejt institucionalizimit të saj në kulturën akademike në vendin tonë.

Ne qëllimisht e evituam këtu togfjalëshin “mendimi sociologjik shqiptar”, pasi embrionet e mendimit sociologjik shqiptar i përkasin një periudhe shumë më të hershme. Ato i gjejmë në mos në të njëjtën kohë me lindjen e mendimit sociologjik evropian, të paktën që me Sami Frashërin në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, pak a shumë në të njëjtën kohë që Émile Durkheim botoi veprat e tij klasike *Ndarja e punës në shoqëri*

(1893), *Rregulla e metodës sociologjike* (1896) dhe *Vetvrasja* (1897), ndërsa Max Weber botoi veprën e tij madhore *Etika protestante dhe shpirti i kapitalizmit* (1904).

Një shqyrtim i vëmendshëm i kësaj bibliografie mund të verë në pah si meritat, ashtu edhe dobësitë e saj. Për dobësitë e saj le të gjykojë lexuesi që do ta marrë në dorë. Ne dëshirojmë të vemë në dukje, sidoqoftë, dy ndër veçoritë që i japin kësaj bibliografie vlerë të veçantë për këdo që është i interesuar ta përdorë atë.

Së pari, ajo që vihet re në këtë vëllim është se zhvillimi i sociologjisë shqiptare gjatë dy dekadave të fundit është kryer përgjatë dy profileve të saj: profilit apo dimensionit *akademik* dhe atij *publik*.

Sociologjia akademike është zhvilluar, ndonëse me disparitetet e veta, si në rrafshin *empirik*, përmes studimeve empirike konkrete në mikromjedise sociale të caktuar apo në shkallë kombëtare, ashtu edhe në atë *teorik*, si për çështje dhe dukuri të realitetit shoqëror shqiptar, ashtu edhe në një kuadër më të gjerë krahasues, transnacional, siç vihet re në disa nga studimet e përfshira në këtë bibliografi.

Përsa i përket *sociologjisë publike*, ajo jo vetëm ka qenë forma e parë në të cilën u shfaq dhe u lëvrua mendimi sociologjik shqiptar në fund të viteve 1980-të dhe në fillim të viteve 1990-të, por vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite “zhanri” më i lëvruar i saj, siç dëshmohet kjo në qindra shkrime dhe artikuj publicistikë të botuar në shtypin shqiptar të përditshëm apo periodik por, ndonjëherë edhe në shtypin e huaj dhe që në këtë vëllim përfshihen në pjesën e tretë të tij. Kjo krijimtari e gjerë ekstra-akademike i jep një frymëmarrje të shëndetshme rolit publik të sociologjisë në shoqëri dhe bashkë me të, vetë disiplinës së sociologjisë për dy arësye kryesore: e para, sepse duke qenë një pasqyrim i drejtpërdrejtë, imediat, i ditëpërditshëm i realitetit shoqëror, ajo përmban potencialisht dhe sugjeron lëndën e parë për mjaft studime sociologjike akademike të mirëfillta; e dyta, sepse ajo stimulon dhe rigjeneron çdo ditë natyrën dhe aftësinë

diagnostikuese dhe transformuese të sociologjisë dhe të shkencës sociale në përgjithësi duke i kontribuar sa zhvillimit të metodologjisë dhe teorisë së saj, aq edhe progresit shoqëror.

Së dyti, ky vëllim bibliografik dëshmon qartë se mendimi sociologjik shqiptar, por edhe ai politik apo ekonomik, është bërë, veçanërisht në këta dhjetë vjetët e fundit, pjesë integrale e tregut bashkëkohor të ideve. Punime shkencore që kanë për autorë studiues shqiptarë përveçse janë kumtuar e kumtohen në dhjetra konferenca ndërkombëtare, janë botuar dhe botohen çdo vit në revista akademike ndërkombëtare, të cilat dalin në Shtetet e Bashkuara apo në Angli, në Gjermani apo në Francë, në Hollandë apo në Itali.

Shkenca nuk është një epifenomen i izoluar nacional. Edhe sociologjia si shkencë transcendenton kufijtë nacionale të shteteve duke pasqyruar shoqërinë në dimensionet e saj lokale dhe globale, duke investiguar probleme e dukuri që kanë të bëjnë me shoqëri periferike rurale por edhe me qendra metropolitane, duke shqyrtuar kulturat “e vogla” tradicionale, ato që antropologu i Shkollës së Çikagos Robert Redfield i quan “little tradition cultures”, por edhe kulturën urbane të megaqyteteve të tillë si Meksiko, Seuli, Nju Jorku, Sao Paulo, Tokio, Mumbai, Delhi, Shanghai, apo Los Anxhelos, çdo njëri prej të cilëve ka një popullsi mbi 18 milion banorë. Sidoqoftë, duke qenë një disiplinë e përgjithsme mbi shoqërinë, sociologjia bashkëkohore është njëkohësisht e kompartmentalizuar (apo e “ballkanizuar”, siç thuhet ndonjëherë) në dhjetra nëndisiplina, të cilat duke pasur çdonjëra fokusin e tyre të veçantë të studimit, krijojnë së bashku, si pjesë të një mozaiku të madh, tablonë e përgjithshme të realitetit shoqëror global, pjesë e të cilit është edhe realiteti shoqëror shqiptar. Këtë realitet shqiptar sot nuk e studjojnë më vetëm apo kryesisht sociologë e huaj, por në radhë të parë sociologë dhe studiues shqiptarë të shkencave sociale, duke i kontribuar në këtë mënyrë zgjerimit dhe thellimit të dijes sociologjike në tërësi.

Edhe pse nuk përfshihen në këtë bibliografi, është i

konsiderueshëm numri i librave dhe artikujve të botuar nga autorë të huaj vitet e fundit, të cilët u referohen dhe citojnë studime të autorëve shqiptarë. Kjo tregon se shkencat shoqërore shqiptare po bëhen gjithnjë e më shumë pjesë integrale e kulturës akademike evropiane dhe asaj botërore dhe vetë sociologjia shqiptare, disiplinë e cila 20 vjet më parë nuk njihet në Shqipëri veçse si emër, po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë e asaj që quhet “Sociology without borders”.

Si hartues dhe redaktorë të vëllimit që mbani në dorë, ne u shprehim mirënjohje të gjithë atyre individëve apo institucioneve që iu përgjigjën pozitivisht kërkesës sonë për të bashkëpunuar në hartimin e kësaj bibliografie. Në mënyrë të veçantë dëshirojmë të falenderojmë administratorët e Alb-shkencës, rrjeti i studiuesve shqiptarë në Internet, dhe ata anëtarë të këtij rrjeti, të cilën e kanë mbështetur këtë projekt dhe kanë kontribuar për realizimin e tij.

Kjo bibliografi, sidoqoftë, do të kishte qenë më e plotë nëse disa autorë shqiptarë do u ishin përgjigjur në mënyrë afirmative ftesës sonë për bashkëpunim. Fatkeqësisht, asociimet apo simpatitë politike dhe xhelozitë akademike kanë bërë që në ndonjë rast ky bashkëpunim të ketë munguar, gjë për të cilën ne, si redaktorë, kemi qenë qysh në fillim të përgatitur. Në raste të tjera, kemi qenë ne që s’kemi mundur të tërheqim sa duhet bashkëpunimin e disa autorëve të tjerë për arsye të cilat kanë qenë jashtë mundësive tona. Sidoqoftë, ndërsa meritat e kësaj bibliografie u përkasin tërësisht atyre autorëve shqiptarë, të cilët me krijimtarinë e tyre të botuar brenda apo jashtë vendit u kanë dhënë përmbajtje dhe *raison d’être* kësaj bibliografie, përgjegjësia për çdo mangësi të saj është e redaktorëve dhe vetëm e tyre.

Për ta saktësuar, plotësuar dhe përmirësuar më tej këtë bibliografi në një botim të dytë të saj në të ardhmen, të gjithë ata studiues dhe individë që kanë botuar apo do të botojnë studime të mirëfillta në fushë të shkencave shoqërore apo shkrime publicistike që trajtojnë probleme

shoqërore në një plan të përgjithshëm janë të ftuar të informojnë redaktorët e këtij vëllimi, të cilët mund të kontaktohen me e-mail në adresat që vijojnë: ftarifa@emich.edu dhe lsokoli@instituti-sociologjise.org

Dr. Fatos Tarifa

Eastern Michigan University

Dr. Lekë Sokoli

Instituti i Sociologjisë, Tiranë

Libra sociologjikë

ALIA, Zana

Alia, Zana. 1988. *Familja socialiste dhe struktura e saj*. Tiranë: 8 nëntori.

BARJABA, Kosta

Barjaba, Kosta. 2004. *Albania's Democratic Elections, 1991-1997 (Analysis, Documents and Data)*. Berlin: Sigma.

Barjaba, Kosta. 2003. *Shqiptarët, këta ikës të mëdhenj*. Tiranë: Korbi.

Barjaba, Kosta. 2002. *Ondate senza ritorno (Scritti e saggi sull'emigrazione albanese)*. Rome: International Organization for Migration.

Barjaba, Kosta. 1997. *Albania. Tutta d'un pezzo, in mille pezzi...E dopo?* Botuar si vëllim i vaçantë i revistës *Futuribili*, 2/3. Milano: Franco Angeli.

Perrone, Luigi, Kosta Barjaba & Georges Lapassade. 1996. *Naufragi Albanesi. Studi Ricerche e Riflessioni sull'Albania*. Roma: Sensibili alle Foglie.

BARKLEY, Thornton

Hazizaj, Altin & Thornton Barkley. 2004. *Mbi gjendjen sociale, psikologjike dhe të të drejtave të fëmijëve në komisariatet e policisë dhe dhomat e paraburgimit*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

BECI, Ledia

Ekonomi, Milva, Englantina Gjermani, Ermira Danaj, Elvana Lula & Ledia Beci. 2006. *Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një Strategji për Parandalimin e Trafikimit*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

BEDDIES, Sabine

De Soto, Hermine, Sabine Beddies & Ilir Gëdeshi. 2005. *Roma and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion*. Washington D.C: The World Bank.

BEQJA, Hamit

Beqja, Hamit. 2004. *Gjurmë Jete*. Tiranë: Uegen.

Beqja, Hamit. 2002. *Galerija dhe plateja*. Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike.

Beqja, Hamit. 2002. *Gruaja, kjo qenie "shenjte"*. Tiranë: Akademia e Shkencave.

Beqja, Hamit. 2002. *Përgjigje letrave rinore*. Tiranë: Botimet Dudaj.

Beqja, Hamit. 2001. *Udhëzues për prindërit*. Tiranë: Qendra e trajtimit multidisiplinar për keqtrajtimin e fëmijëve.

Beqja, Hamit. 2001. *Udhëzues për mësuesit*. Tiranë: Qendra e trajtimit multidisiplinar për keqtrajtimin e fëmijëve.

Beqja, Hamit & Lekë Sokoli. 2000. *Divorci-vrojtime e refleksione*. Tiranë: Dudaj.

Beqja, Hamit. 2000. *Procesi i tranzicionit demokratik dhe psikologjia e shqiptarit të sotëm*. Tiranë: Akademia e Shkencave.

Beqja, Hamit. 1999. *Qytetari dhe zyrtari*. Tiranë: Shoqata për Kulturë Demokratike.

- Beqja, Hamit. 1996. *Dashuria, seksi, studentët e mi*. Tiranë: Albin.
- Beqja, Hamit. 1994. *Edhe ëngjëlli, edhe djalli, janë brenda tek i gjalli. Rreth dyzimit të personalitetit njerëzor*. Tiranë: Albin.
- Beqja, Hamit. 1991. *Për rininë, me rininë*. Tiranë: 8 nëntori.
- Beqja, Hamit. 1989. *Rrjedhave të sociologjisë së edukatës e të kulturës*. Tiranë: 8 nëntori.
- Beqja, Hamit. 1988. *Edukata në syrin e popullit*. Tiranë: Shtëpia botuese e Librit Universitar.
- Beqja, Hamit. 1987. *Kë edukojmë, si edukojmë*. Tiranë: 8 nëntori.
- Beqja, Hamit. 1986. *Si sillemi, ç'zakone ndjekim?* Tiranë: 8 nëntori.

BEZHANI, Mimoza

- Bezhani, Mimoza. 1999. *Biznesi i gruas në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Gruas.

BIBERAJ, Elez

- Biberaj, Elez. 2001. *Shqipëria në tranzicion: Rruga e vështirë drejt demokracisë*. Tiranë: Ora.
- Biberaj, Elez. 1998. *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*. Boulder, Colorado: Westview Press.
- Biberaj, Elez. 1990. *Albania: A Socialist Maverick*. Boulder, Colorado: Westview Press.

BOGDANI, Mirela

- Loughlin, John & Mirela Bogdani. 2004. *Albania and the European Union: European Integration and the Prospect of Accession*. Tiranë: Dajti 2000.

BREGU, Majlinda

- Haxhiymeri, Edlira, Eliona Kulluri, **Majlinda Bregu** & Izela Tahsini. 2006. *Vlerësimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit shëndetësor për të adresuar problemet e dhunës me bazë gjinore*. Tiranë: Pegi.
- Haxhiymeri, Edlira, **Majlinda Bregu**, Genci Burazeri, Eglantina Gjermani & Blerta Picari. 2006. *Dhuna në familje: Paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.
- Gjermani, Eglantina & Marsela Dauti & **Majlinda Bregu**. 2004. *Ndjeshmëria e medias së shkruar ndaj çështjeve gjinore në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

BUMÇI, Aldo

- Rakipi, Albert, **Aldo Bumçi** & Blendi Kajsio. 2002. *Albania: A Weak democracy a weak state*, Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.

BURAZERI, Genci

- Haxhiymeri, Edlira, Majlinda Bregu, **Genci Burazeri**, Eglantina Gjermani & Blerta Picari. 2006. *Dhuna në familje: Paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

ÇARÇANI, Lida

- Meçe, Emanuela, Arjana Çepani, **Lida ÇARÇANI** & Sonila Qirjaku. 1998. *Gruaja në Biznes në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Gruas.

ÇAUSHI, Entela

Picari, Blerta, Sonila Turshilla & **Entela Çaushi**. 2005. *Monitorimi i medias gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

ÇELA, Elira

Elira Çela. 1992. *Tradita afetare të popullit shqiptar*. Tiranë: 8 Nëntori.

ÇEPANI, Arjana

Meçe, Emanuela, **Arjana Çepani**, Lida Çarçani & Sonila Qirjaku. 1998. *Gruaja në Biznes në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Gruas.

DALIPAJ, Mirela

King, Russell, Nicola Mai & **Mirela Dalipaj**. 2004. *Exploring the Migration Myths: Analysis and Recommendations for the European Union, the UK and Albania*. London: Oxfam.

DANAJ, Ermira

Ekonomi, Milva, Englantina Gjermani, **Ermira Danaj**, Elvana Lula & Ledia Beci. 2006. *Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: një Strategji për Parandalimin e Trafikimit*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

DAUTI, Marsela

- Gjermani, Eglantina, Elvana Lula, **Marsela Dauti** & Admir Meko. 2005. *Monitorimi dhe Vlerësimi nën Këndvështrimin Gjinator* Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- Gjermani, Eglantina & **Marsela Dauti** dhe Majilinda Bregu. 2004. *Ndjeshmëria e medias së shkruar ndaj çështjeve gjimore në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

DEMIRI, Jashar

- Demiri, Jashar. 1992. *Psikologji intime dhe sekrete dashurie*. Tiranë: Toena.
- Demiri, Jashar. 1992. *Edukata seksuale*. Tiranë: Rinia.

DERVISHI, Zyhdi

- Dervishi, Zyhdi. 2004. *Vullnetarizmi: ind shumëdimensional i shoqërisë*. Tiranë: AlbPaper.
- Dervishi, Zyhdi & Artan Fuga. 2002. *Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global: Integrimi social i të rinjve të zonave fshatare në dritëhijet e arsimit të mesëm (Trajtesë sociologjike)*. Tiranë: Jeruzalemi.
- Dervishi, Zyhdi. 2001. *Bashkëjetesë me demonët e konflikteve*. Tiranë: Jeruzalemi.
- Dervishi, Zyhdi. 2000. *Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva*. Tiranë: Dora d'Istria.
- Dervishi, Zyhdi. 1999. *Vështrime të kryqëzuara në det: Analizë ndërkulturore përmes integrimit sociokulturor të emigrantëve shqiptarë në Itali*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.

DE SOTO, Harmine

- De Soto, Hermine**, Sabine Beddies & Ilir Gëdeshi. 2005. *Roma and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion*. Washington D.C: The World Bank.
- De Soto, Hermine**, Piter Gordon, Ilir Gëdeshi & Zamira Sinoimeri. 2002. *Poverty in Albania. A Qualitative Assessment*. Washington, D.C.: The World Bank.

DEVOLE, Rando

- Vehbiu, Adrian & **Rando Devole**. 1996. *La Scoperta dell'Albania. Gli albanesi secondo i mass media*. Milan: Paoline.

De ZWAGER, N.

- De Zwager, N.**, Ilir Gëdeshi, E. Germenji & Ch. Nikas. 2005. *Competing for remittances*. Tirana: IOM, 2005.

DRAGOTI, Edmond

- Leskaj, Valentina, **Edmond Dragoti**, Theodhori Karaj & Fiona Todhri. 2004. *Shoqëria shqiptare përballë sfidave të trafikut të grave dhe vajzave*. Tiranë: ISOP.
- Dragoti, Edmond**. 1999. *Psikologjia Sociale*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Dragoti, Edmond**, Theodhori Karaj, Adem Tamo, Milika Dharmo & Edlira Haxhiymeri. 1996. *Puna Sociale*. Tiranë: Toena.

DOJA, Albert

- Doja, Albert** (ed.). 2001. *Ethnic Relations in Eastern Europe: A*

Selected and Annotated Bibliography. Budapest: Open Society Institute LGI Books.

Doja, Albert. 2000. *Naître et Grandir chez les Albanais: La Construction Culturelle de la Personne.* Paris: L'Harmattan.

DHAMO, Milika

Dragoti, Edmond. Theodhori Karaj, Adem Tamo, **Milika Dharmo** & Edlira Haxhiymeri. 1996. *Puna Sociale.* Tiranë: Toena.

DHIMITRI, Rolanda

Fullani, Arjana, Violanda Theodhori, Milva Ekonomi, Marta Muço, Fatmira Rama, Sivana Mira, Valdet Sala, Sonila Qirjaku & **Rolanda Dhimitri.** 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98.* Tiranë: Qendra e Gruas.

Gëdeshi, Ilir, Hekuran Mara, **Rolanda Dhimitri** & Ksenofon Krisafi. 1999. *Emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit.* Tiranë: Luarasi.

EKONOMI, Milva

Ekonomi, Milva, Eglantina Gjermani, Ermira Danaj, Elvana Lula & Ledia Beci. 2006. *Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një Strategji për Parandalimin e Trafikimit.* Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

Fullani, Arjana, Violanda Theodhori, **Milva Ekonomi,** Marta Muço, Fatmira Rama, Sivana Mira, Valdet Sala, Sonila Qirjaku & Rolanda Dhimitri. 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98.* Tiranë: Qendra e Gruas.

FUGA, Artan

- Fuga, Artan.** 2004. *Les mots dans la communication politique en Albanie*. Paris: L'Harmattan, 2004.
- Fuga, Artan.** 2003. *Majtas jo djathtas: ndryshimi te socialisët shqiptarë në këndvështrimin e filozofisë politike bashkëkohore*. Tiranë: Ora.
- Dervishi, Zyhdi & Artan Fuga.** 2002. *Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global: Integrimi social i të rinjve të zonave fshatare në dritëhijet e arsimimit të mesëm*. Tiranë: Jeruzalemi, 2002.
- Fuga, Artan.** 2001. *Shtigje drejt guvës së gjarprit*. Tiranë: Ora, 2001.
- Fuga, Artan.** 2000. *Identités périphériques en Albanie (La structuration du milieu rural et les nouvelles dynamiques politiques)*. Paris: L'Harmattan.
- Fuga, Artan.** 1999. *L'Albanie entre la pensée totalitaire et la raison fragmentaire*. Paris: L'Harmattan, 1999.

FULLANI, Arjana

- Fullani, Arjana, Violanda Theodhori, Milva Ekonomi, Marta Muço, Fatmira Rama, Sivana Mira, Valdet Sala, Sonila Qirjaku & Rolanda Dhimitri.** 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98*. Tiranë: Qendra e Gruas.

GËDESHI, Ilir

- Sokoli, Lekë & Ilir Gëdeshi.** 2006. *Trafikimi, rasti i Shqipërisë*. Tiranë: Rinia & Instituti i Sociologjisë.
- De Soto Hermine, Sabine Beddies & Ilir Gëdeshi.** 2005. *Roma and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion*. Washington D.C: The World Bank.

- De Zwager N., **Ilir Gëdeshi**, Englantina Germenji & Ch. Nikas. 2005. *Competing for remittances*. Tirana: International Organisation for Migration.
- De Soto Hermine, Peter Gordon, **Ilir Gëdeshi** & Zamira Sinoimeri. 2002. *Poverty in Albania. A Qualitative Assessment*. Washington, D.C.: The World Bank.
- Gëdeshi, Ilir**, Hekuran Mara, Rolanda Dhimitri & Ksenofon Krisafi. 1999. *Emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit*. Tiranë: Luarasi.

GËLLÇI, Diana

- Gëllçi, Diana**. 2005. *Gjakmarrja: Albanian Highlander's "Blood Feud" as Social Obligation*. Tiranë: Albanian Institute for International Studies.

GJERMENI, Englantina

- Haxhiymeri, Edlira, Majlinda Bregu, Genci Burazeri, **Englantina Gjermeni** & Blerta Picari. 2006. *Dhuna në familje: Paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- Ekonomi, Milva, **Englantina Gjermeni**, Ermira Danaj, Elvana Lula & Ledia Beci. 2006. *Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: një Strategji për Parandalimin e Trafikimit*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- Gjermeni, Englantina**, Elvana Lula, Marsela Dauti & Admir Meko. 2005. *Monitorimi dhe Vlerësimi nën Këndvështrimin Gjinator*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- Gjermeni, Englantina**. 2004. *Shprehi në praktikën e punës sociale*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Gjermeni, Englantina**, Marsela Dauti & Majlinda Bregu.

2004. *Ndjeshmëria e medias së shkruar ndaj çështjeve gjinore në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

GJONÇA, Arjan

Gjonça, Arjan. 2001. *Communism, Health and Lifestyle: The Paradox of Mortality Transition in Albania, 1950-1990*. Portsmouth: Greenwood Press.

HAKO, Hulusi

Hako, Hulusi. 2005. *Toleranca, politika, ligji, kultura, ateizmi dhe feja sot në botë*. Tiranë: ISPS & Rinia, 2005.

HAXHIYMERI, Edlira

Haxhiymeri, Edlira, Eliona Kulluri, Majlinda Bregu & Izela Tahsini. 2006. *Vleresimi i kapaciteteve te punonjesve te sherbimit shendetesor per te adresuar problemet e dhunes me baze gjinore*. Tiranë: Pegi.

Haxhiymeri, Edlira, Majlinda Bregu, Genci Burazeri, Eglantina Gjermani & Blerta Picari. 2006. *Dhuna në familje: Paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

Haxhiymeri, Edlira, Eliona Kulluri & Altin Hazizaj. 2005. *Abuzimi me fëmijët në familje*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Dragoti, Edmond. Theodhori Karaj, Adem Tamo, Milika Dhamo & Edlira Haxhiymeri. 1996. *Puna Sociale*. Tiranë: Toena.

HAZIZAJ, Altin

- Maksutaj, Alma & **Altin Hazizaj**. 2005. *Shkaqet dhe pasojat e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve në Shqipëri*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
- Haxhiymeri, Edlira, Eliona Kulluri & **Altin Hazizaj**. 2005. *Abuzimi me fëmijët në familje*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
- Hazizaj, Altin**. 2004. *Mundesitë e punësimit të të rinjëve në Shqipëri*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
- Hazizaj, Altin** & Thornton Barkley. 2004. *Mbi gjendjen sociale, psikologjike dhe të të drejtave të fëmijëve në komisariatet e policisë dhe dhomat e paraburgimit*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

KAJSIU, Blendi

- Rakipi, Albert, Aldo Bumçi & **Blendi Kajsiu**. 2002. *Albania: A Weak democracy a weak state*. Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.

KARAJ, Theodhori

- Leskaj, Valentina, Edmond Dragoti, **Theodhori Karaj** & Fiona Todhri. 2004. *Shoqëria shqiptare përballë sfidave të trafikut të grave dhe vajzave*. Tiranë: ISOP.

KATRO, Jeta

- Katro, Jeta** & Liri Shimani. 1999. *Prostitucioni dhe trafiku i gruas në Shqipëri*. Tiranë: Lilo.

KING, Russell

King, Russell, Nicola Mai & Mirela Dalipaj. 2004. *Exploring the Migration Myths: Analysis and Recommendations for the European Union, the UK and Albania*. London: Oxfam.

KRASNIQI, Afrim

Krasniqi, Afrim. 2006. *Partitë politike në Shqipëri, 1990-2006*. Tiranë: Geer.

Krasniqi, Afrim. 2004. *Shoqëria civile në Shqipëri: Historia e lindjes, zhvillimit dhe sfidat e saj*. Tiranë: Geer.

Krasniqi, Afrim. 2001. *Burimet e konfliktit politik në Shqipëri*. Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.

Krasniqi, Afrim. 2001. *Korrupsioni dhe tranzicioni shqiptar*. Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.

Krasniqi, Afrim. 1998. *Fundi i Siberisë Shqiptare*. Tiranë: Albin.

Krasniqi, Afrim. 1998. *Rënia e demokracisë*. Tiranë: Eurorilindja.

KRISAFI, Ksenofon

Gëdeshi, Ilir, Hekuran Mara, Rolanda Dhimitri & **Ksenofon Krisafi**. 1999. *Emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit*. Tiranë: Luarasi.

KULLA, Ndriçim

Kulla, Ndriçim. 2002. *Shqiptarizma, një model i braktisur*. Tiranë: Plejad.

KULLURI, Eliona

- Haxhiymeri, Edlira, **Eliona Kulluri**, Majlinda Bregu & Izela Tahsini. 2006. *Vlerësimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit shëndetsor për të adresuar problemet e dhunës me bazë gjinore*. Tiranë: Pegi.
- Haxhiymeri, Edlira, **Eliona Kulluri** & Altin Hazizaj. 2005. *Abuzimi me fëmijët në familje*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

LAPASSADE, Georges

- Perrone, Luigi, Kosta Barjaba & **Georges Lapassade**. 2006. *Naufragi albanesi: Studi ricerche e riflessioni sull'Albania*. Roma: Sensibili alle Foglie.

LESKAJ, Valentina

- Leskaj, Valentina**, Edmond Dragoti, Theodhori Karaj & Fion Todhri. 2004. *Shoqëria shqiptare përballë sfidave të trafikut të grave dhe vajzave*. Tiranë: ISOP.

LOUGHLIN, John

- Loughlin, John** & Mirela Bogdani. 2004. *Albania and the European Union: European Integration and the Prospect of Accession*. Tiranë: Dajti 2000.

LUBONJA, Fatos

- Lubonja, Fatos**. 1999. *Liri e kërcënuar*. Tiranë: Botimet Përpjekja.

LULA, Elvana

Ekonomi, Milva, Englantina Gjermani, Ermira Danaj, **Elvana Lula** & Ledia Beci. 2006. *Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një Strategji për Parandalimin e Trafikimit*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim, 2006.

Gjermani, Englantina, **Elvana Lula**, Marsela Dauti & Admir Meko. 2005. *Monitorimi dhe Vlerësimi nën Këndvështrimin Gjitor*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

MAI, Nicola

King, Russell, **Nicola Mai** & Mirela Dalipaj. 2004. *Exploring the Migration Myths: Analysis and Recommendations for the European Union, the UK and Albania*. London: Oxfam.

MAKSUTAJ, Alma

Maksutaj, Alma & Altin Hazizaj. 2005. *Shkaqet dhe pasojat e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve në Shqipëri*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Maksutaj, Alma. 2004. *Trafikimi i fëmijëve për shfrytëzim seksual*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Maksutaj, Alma. 2003. *Rreth trafikimit të fëmijëve në Shqipëri*. Tiranë: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

MARA, Hekuran

Gëdeshi, Ilir, **Hekuran Mara**, Rolanda Dhimitri & Ksenofon Krisafi. 1999. *Emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit*. Tiranë: Luarasi.

MEÇE, Emanuela

Meçe, Emanuela, Arjana Çepani, Lida Çarçani & Sonila Qirjaku. 1998. *Gruaja në Biznes në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Gruas.

MEKO, Admir

Gjermani, Eglantina, Elvana Lula, Marsela Dauti & **Admir Meko**. 2005. *Monitorimi dhe Vlerësimi nën Këndvështrimin Gjinator*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

Meko, Admir & Izela Tahsini. 2004. *Integrimi gjinator në arsim*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

MIRA, Silvana

Mira, Silvana. 2001. *Shtypi mbi dhunën ndaj gruas*. Tiranë: Qendra e Gruas.

Fullani, Arjana, Violanda Theodhori, Milva Ekonomi, Marta Muço, Fatmira Rama, **Sivana Mira**, Valdet Sala, Sonila Qirjaku & Rolanda Dhimitri. 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98*. Tiranë: Qendra e Gruas.

MISJA, Vladimir

Misja, Vladimir. 1998. *Emigracioni ndërkombëtar në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit*. Tiranë: Marlin Barleti.

MUÇO, Marta

Fullani, Arjana, Violanda Theodhori, Milva Ekonomi, **Marta Muço**, Fatmira Rama, Sivana Mira, Valdet Sala, Sonila

Qirjaku & Rolanda Dhimitri. 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98*. Tiranë: Qendra e Gruas.

MUSAJ, Fatmira

Musaj, Fatmira. 2002. *Gruaja në Shqipëri (1912-1939)*. Tiranë: Akademia e Shkencave.

OMARI, Donika

Omari, Donika. 2006. *Shqiptarët kundër vetvetes. Pse?* Tiranë: Elena Gjika.

PERRONE, Luigi

Perrone, Luigi, Kosta Barjaba & Georges Lapassade. 1996. *Naufraqi albanesi: Studi ricerche e riflessioni sull'Albania*. Roma: Sensibili alle Foglie.

PËLLUMBI, Servet

Pëllumbi, Servet. 2005. *Edhe politika do moral*. Tiranë: ISPS & Rinia.

Pëllumbi, Servet. 2002. *Sprova në sociologjinë politike*. Tiranë: Dudaj.

Pëllumbi, Servet. 2002. *Gjurmime sociologjike*. Tiranë: Dudaj.

Pëllumbi, Servet. 2001. *Të mendosh ndryshe*. Tiranë: Dudaj.

Pëllumbi, Servet. 2000. *Dritëhijet e tranzicionit*. Tiranë: Rinia.

PICARI, Blerta

- Haxhiymeri, Edlira, Majlinda Bregu, Genci Burazeri, Englantina Gjermani & **Blerta Picari**. 2006. *Dhuna në familje: Paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- Valdet Sala & **Blerta Picari**. 2005. *Barazia Gjimore Kusht për në Integrimin Evropian*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- Picari, Blerta**, Sonila Turshilla & Entela Çausi. 2005. *Monitorimi i medias gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

QIRJAKU, Sonila

- Fullani, Arjana, Violanda Theodhori, Milva Ekonomi, Marta Muço, Fatmira Rama, Sivana Mira, Valdet Sala, **Sonila Qirjaku** & Rolanda Dhimitri. 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98*. Tiranë: Qendra e Gruas.
- Meçe, Emanuela, Arjana Çepani, Lida Çarçani & **Sonila Qirjaku**. 1998. *Gruaja në Biznes në Shqipëri*. Tiranë: Qendra e Gruas.

RAMA, Fatmira

- Fullani, Arjana, Violanda Theodhori, Milva Ekonomi, Marta Muço, **Fatmira Rama**, Sivana Mira, Valdet Sala, Sonila Qirjaku & Rolanda Dhimitri. 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98*. Tiranë: Qendra e Gruas.

RAKIPI, Albert

- Rakipi, Albert**. 2006. *Weak States and Security*, Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.

Rakipi, Albert, Aldo Bumçi & Blendi Kajsiu. 2002. *Albania: A Weak democracy a weak state*, Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.

SALA, Valdete

Valdet Sala & Blerta Picari. 2005. *Barazia Gjinore Kusht për në Integrimin Evropian*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

Fullani, Arjana, Violanda Theodhori, Milva Ekonomi, Marta Muço, Fatmira Rama, Sivana Mira, Valdet Sala, Sonila Qirjaku & Rolanda Dhimitri. 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98*. Tiranë: Qendra e Gruas.

SAQELLARI, Spiro

Saqellari, Spiro. 2006. *Fjalët e para si hapat e parë. Rëndësia e komunikimit përgjatë viteve të fëmijërisë në zhvillimin e të folurit e më gjerë*. Tiranë: Onufri.

Saqellari, Spiro. 2004. *Mosrrjedhshmëria dhe belbëzimi*. Tiranë: Albin.

Saqellari, Spiro. 2003. *Fëmija im akoma nuk po flet. Çfarë të bëj?* Tiranë: Albin.

SOKOLI, Lekë

Sokoli, Lekë. 2006. *Analiza sociologjike*. Tiranë: Rinia & Instituti i Sociologjisë.

Sokoli, Lekë. 2006. *Prostitucioni si profesion (vështrim sociologjik)*. Tiranë: Rinia & Instituti i Sociologjisë.

Sokoli, Lekë. 2006. *Sociologjia dhe jeta e përditshme (Sociologji publike I)*. Tiranë: Rinia & Instituti i Sociologjisë.

- Sokoli, Lekë & Ilir Gëdeshi.** 2006. *Trafikimi, rasti i Shqipërisë*. Tiranë: Rinia & Instituti i Sociologjisë.
- Sokoli, Lekë.** 2003. *Interesat dhe harmonizimi i tyre*. Tiranë: ISPS & Rinia.
- Sokoli, Lekë.** 2002. *Demokracia dhe problemet sociale (Studime sociologjike I)*. Tiranë: ISPS & Rinia.
- Sokoli, Lekë.** 2000. *Themeluesit e sociologjisë*. Tiranë: Rinia.
- Sokoli, Lekë.** *Droga* (Ribotim i përshtatur për nivelin shkollor). Tiranë: Rinia.
- Beqja, Hamit & Lekë Sokoli.** *Divorci—vrojtime e refleksione*. Tiranë: Dudaj.
- Sokoli, Lekë.** 1999. *Droga: historia, përkufizime, klasifikimi, përhapja, efektet, Terapia*. Tiranë: Onufri & Fondacioni Soros.
- Sokoli, Lekë.** 1997. *Sociologjia*. Tiranë: Elio.

SPOOR, Max

- Tarifa, Fatos & Max Spoor (eds.). 2000. *The First Decade and After: Albania's Democratic Transition and Consolidation in the Context of Southeast Europe*. The Hague: Institute of Social Studies.

SULSTAROVA, Enis

- Sulstarova, Enis.** 2006. *Arratisje nga Lindja. Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*. Tiranë: Dudaj.
- Sulstarova, Enis.** 2003. *Ligjërimi nacionalist në Shqipëri*. Tiranë: Afërdita.

SULA, Zihni

- Sula, Zihni.** 1999. *Droga dhe të rinjtë*. Tiranë: Ombra GVG.

SHIMANI, Liri

Katro, Jeta & Liri Shimani. 1999. *Prostitucioni dhe trafiku i gruas në Shqipëri*. Tiranë: Lilo.

TAHSINI, Izela

Haxhiymeri, Edlira, Eliona Kulluri, Majlinda Bregu & Izela Tahsini. 2006. *Vleresimi i kapaciteteve te punonjesve te sherbimit shendetesor per te adresuar problemet e dhunes me baze gjinore*. Tiranë: Pegi.

Meko, Admir & Izela Tahsini. 2004. *Integrimi gjinor në arsim*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

TAMO, Adem

Dragoti, Edmond. Theodhori Karaj, Adem Tamo, Milika Dhamo & Edlira Haxhiymeri. 1996. *Puna Sociale*. Tiranë: Toena.

TARIFA, Fatos

Tarifa, Fatos. 2006. *To Albania with Love*. Lanham, Maryland: University Press of America.

Tarifa, Fatos. 2004. *Defending and Improving Democracy in Modern Albania*. Tiranë: Globus R.

Tarifa, Fatos. 2003. *Social Problems of Transition*. The Hague: Smiet.

Tarifa, Fatos. 2002. *Kërkimi i legjitimitetit dhe venitja e utopisë*. Tiranë: Globus R.

Tarifa, Fatos. 2001. *The Quest for Legitimacy and the Withering Away of Utopia*. The Hague: Smiet, 2001.

Tarifa, Fatos (ed.). 2001. *The Breakdown of State Socialism and*

the Emerging Post-Socialist Order. The Hague: Institute of Social Studies.

Tarifa, Fatos. *Culture, Ideology and Society*. The Hague: Smiet.

Tarifa, Fatos. 2001. *Who's Who in Sociology*. The Hague: Smiet

Tarifa, Fatos & Max Spoor (eds.), 2000. *The First Decade and After: Albania's Democratic Transition and Consolidation in the Context of Southeast Europe*. The Hague: Institute of Social Studies.

Tarifa, Fatos (ed.), 1998. *Open-Ended History: Dangers and Dilemmas of Transition*. Botuar si vëllim i veçantë i revistës akademike *Journal of Social Sciences*, 2(2-3). Delhi: Kamla-Raj Enterprises.

Tarifa, Fatos. 1991. *Në kërkim të faktit sociologjik*. Tiranë: 8 Nëntori.

TODHRI, Fiona

Leskaj, Valentina, Edmond Dragoti, Theodhori Karaj & **Fiona Todhri.** 2004. *Shoqëria shqiptare përballë sfidave të trafikut të grave dhe vajzave*. Tiranë: ISOP.

TURSHILLA, Sonila

Picari, Blerta, **Sonila Turshilla** & Entela Çausi. 2005. *Monitorimi i medias gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve*. Tiranë: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

TUSHI, Gëzim

Tushi, Gëzim. 2006. *Shoqëria civile*. Tiranë: Albin.

Tushi, Gëzim. 2006. *Probleme dhe dilema sociale*. Tiranë: Dudaj.

Tushi, Gëzim. 1998. *Politika, fatalitet i kohës*. Tiranë: Albin.

THEODHORI, Violanda

Fullani, Arjana, **Violanda Theodhori**, Milva Ekonomi, Marta Muço, Fatmira Rama, Sivana Mira, Valdet Sala, Sonila Qirjaku & Rolanda Dhimitri. 2000. *Mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri '90-'98*. Tiranë: Qendra e Grua.

VEHBIU, Adrian

Vehbiu, Ardian. 2006. *Kuzhinat e Kujtesës*. Elbasan: Sejko.

Vehbiu, Ardian. 2004. *Zhargonet e Kombit*. Elbasan: Sejko.

Vehbiu, Ardian. 2003. *Kulla e Sahatit*. Tiranë: K & B.

Vehbiu, Adrian & Rando Devole. 1996. *La Scoperta dell'Albania. Gli albanesi secondo i mass media*. Milano: Paoline.

UÇI, Alfred

Uçi, Alfred. 2001. *Paradigma të ndërgjegjes shoqërore*. Tiranë: Mësonjëtorja e Parë.

Studime,
artikuj studimorë,
dhe kapituj librash

ALPION, Gëzim

Alpion, Gëzim, “Western Media and the European ‘Other’: Images of Albania in the British Press in the New Millennium”, *Albanian Journal of Politics* (2005), 1 (1): 4-25.

ASCHE, Hartmut

Asche, Hartmut, Dhimitër Doka & Arqile Bërxfholi, “Demographic Atlas of Albania: Pilot project for a National Atlas Information System in a South East European transformation country”, botuar në: *South Eastern European countries on their way to Europe*, 2006, ff. 169-182.

BALAJ, B.

Gjonça, Arjan, G. La Cava, R. Nanetti, S. Schawandner-Sievers, T. Nezam & **B. Balaj**, “Conflict and Change in Kosovo: Impact on Institutions and Society”, Washington, D.C., World Bank, ECSSD, 2001.

BARJABA, Kosta

Barjaba, Kosta & Russell King, “Introducing and theorising Albanian migration”, botuar në: Russell King, Nicola Mai & Stephanie Schwandner-Sievers (eds.), *The New Albanian migration*. Brighton: Sussex Academic Press, 2005.

- Barjaba, Kosta**, "Recent Implications of Inter-Ethnic Relations in Albania", *Anthropological Journal on European Culture* (2005), 4 (1).
- Barjaba, Kosta**, "Migration and Ethnicity in Albania: Synergies and Interdependencies", *The Brown Journal of World Affairs* (2004), 11 (1): 231-239.
- Barjaba, Kosta**, "Contemporary Patterns in Albanian Migration", *South-East Europe Review* (2000), 3 (2): 57-64.
- Barjaba, Kosta**, "Nga 'clandestine' në 'displaced people': Emigrimi në kontekstin e zhvillimeve ekonomike, politike e sociale në Shqipëri". *Përpyekja* (1997), 10.
- Barjaba, Kosta**, Zyhdi Dervishi & Luigi Perrone, "L'emigrazione Albanese: spazi, tempi e sause", *Studi emigrazione* (1992), 29 (107): 513-537.
- Tarifa, Fatos & **Kosta Barjaba**, "Vështrim sociologjik mbi kohën e lirë të punonjësve", *Studime Politiko Shoqërore* (1986), 11: 116-133.

BAUMHACKL, H.

- Doka, Dhimitër & **H. Baumhackl**, "Erwerbstätigkeit und Arbeitslosigkeit in Albanien Mitte der 90er Jahre", *Europa Regional* (1998), 1: 37-44.

BECKER, H.

- Becker, H.**, A. Bloechl & Dhimitër Doka, "Industrie-Squatter in Tirana. Informelles Wohnen in aufgelassenen Kombinatzen der albanischen Hauptstadt", *Europa Regional* (2005), 13 (1): 12-20.
- Becker, H.**, Daniel Göler & Arqile Bërxfholi, "Transformation industrieller Standorte in der Stadtregion Tirana (Albanien)", *Europa regional* (2002), 10 (1): 2-10.

BEDDIES, Sabine

